



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1207/23 Datë: 15/09/2023

Në mbështetje të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ, Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ, Nr.20/12 qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, (përditësuar me vendimin Ref.932/22), Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 115-të, të mbajtur më 25.08.2023, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit i Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë, për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2023 – 30 shtator 2026):
 - I. Juridik i përgjithshëm, LLB, 240 ECTS (Riakreditim); me kuotën maksimimi 100 studentë për vit akademik;
- II. Numri i studentëve si në paragrafin I zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Universiteti Haxhi Zeka në Pejë që deri më datë 15.11.2023 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit.
- IV. Obligohet Universiteti Haxhi Zeka në Pejë, të raportoj dhe arsyetoj çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshim të bartësve aprovet me vendim nga KSHC.
- V. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë si në pikën I, mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti Haxhi Zeka në Pejë, ka parashtruar kërkesë Nr.Prot.1854/22 e datës 31.10.2022 pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (tutje AKA), për ri/akreditimin e programit të studimit;

- *Juridik i përgjithshëm, LLB, 240 ECTS (Riakreditim);*

KShC kishte marr vendim Ref.133/23 me datë 09.02.2023, për arsye të mungesës së bartësve sipas kritereve të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, (përditësuar me vendimin Ref.932/22), kishte refuzuar aplikacionin/kërkesën Nr.Prot.1854/22 të datës 31.10.2022.

Më pastaj në afatin ligjor Universiteti Haxhi Zeka në Pejë kishte parashtruar ankesë në Komisionin e ankesave me Nr.prot 273/23H me datë 09.03.2023. Komisioni i ankesave i AKA me vendim Nr.prot.555/23 të datës 26.04.2023 kishte aprovuar pjesërisht ankesën dhe i kishte propozuar KShC-së që të ndryshoj vendimin.

Në ndërkohë Universiteti Haxhi Zeka në Pejë, kishte parashtruar një kërkesë në KShC për rishqyrtim të vendimit, duke ofruar njëkohësisht ndryshimin e listë së bartëse të programit. KShC pas verifikimit të listës së stafit akademik, kishte aprovuar kërkesën dhe më pastaj kishin vazhduar procedurat e akreditimit ashtu siç është e rregulluar me Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018).

Universiteti Haxhi Zeka në Pejë brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për akreditimin e programit të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Juridik i përgjithshëm, LLB, 240 ECTS (Riakreditim);</i>	Sabiha Shala Kole Krasniqi Mensur Morina Avdullah Robaj

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universiteti Haxhi Zeka në Pejë.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtarë) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit; *Juridik i përgjithshëm, LLB, 240 ECTS (Riakreditim);* vizita me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Peter Parycek, Lali Giorgitze është organizuar më 26 korrik 2023, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht dy (2), Substancialisht dy (2) Pjesërisht tri (3) standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 115-të, të mbajtur më datë 25.08.2023, ka shqyrtuar dokumentacionin e Universiteti Haxhi Zeka në Pejë, si dhe propozimin e Komisionit të Ankesave, dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala mund të parashtroj ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë,
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.




Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë